



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MAJLINDA DEMOLLARI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR.
1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA
NR .10
TEL: 0682061560

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË **NDRYSHME OSE NË DEKLARATA** **PERSONALE**

Nr. repertori: 9055

Tirane më 06/11/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2025053790633044531

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI**



V2025053790633044531

**DATE 06/11/2025
NR REP 9055**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 06/11/2025 (dymije e njezete e pese) , para meje Notere MAJLINDA DEMOLLARI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR. 1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA NR .10, u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Florian Dedja, atësia Skënder, amësia Hajrie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Ramazan Bogdani; Nd. 54; H. 4; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 28/04/1998, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032948217 dhe nr. personal J80428053V ,

Ortaku themelues i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, me deklaroi qe ka nenshkruar Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise “NOVA AUTO” shpk, lëshuar më datë 06/11/2025, në Rruga Mujo Ulqinaku, Pallati nr.5 shqiperi ”, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19/12/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

MAJLINDA DEMOLLARI



AKTI I THEMELIT DHE STATUTI I SHOQËRISË "NOVA AUTO" shpk

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar SH.P.K "Nova Auto" është krijuar sot me ____/11/2025 (dymije e njëzete e pese), sipas Statutit të përpiluar dhe nënshkruar nga Ortaku I Vetem:

- **Z. Florian Dedja**, atësia Skënder, amësia Hajrie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANE, me adresë Ramazan Bogdani; Nd. 54; H. 4; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 28/04/1998, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032948217 dhe nr. personal J80428053V.

Ne cilesine e "Ortakut themelues te Shoqërise "Nova Auto" shpk, me vullnet te lire, te plote e te singerte, dhe iniciativen e lire private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtarët dhe Shoqërite tregtare", ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit", në ate Doganor, Fiskal e Tatimor, themeloj Shoqërine me përgjegjesi te kufizuar me emërtimin "Nova Auto" shpk. (më poshte e quajtur "Shoqëria")

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria "Nova Auto" shpk, është person juridik i te drejtes Shqiptare, Shoqëri me përgjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti Juridik

- 2.1 Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne QKR.
- 2.2 Kontributi i ortakeve/ortakes perben kapitalin e regjistruar te Shoqërise.

Neni 3

Selia

- 3.1 Adresa e kesaj Shoqërie, do jetë: Rruga "Mujo Ulqinaku", Pallati Nr.5, Kati Nr.1, Ap. Nr.1, Zone Kadastrale 8380, Numer Pasurie 3/127-N4.
- 3.2 Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese se pergjithshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarisë do jetë: "Import, eksport, tregtim, shitje dhe blerje e automjeteve të lehta dhe të rënda, përfshirë makina, motoçikleta, autobusë, kamionë dhe çdo lloj tjetër automjeti, duke përfshirë ketu dhe mjetet lundruese apo detare; marrje me qira, leasing, financim dhe qiramarrje e automjeteve për individë dhe kompani; servisimi, mirëmbajtja, riparimi, rinovimi dhe rikonstruksioni i automjeteve; shitja e pjesëve rezervë, aksesorëve, pajisjeve dhe komponentëve të automjeteve; krijim, zhvillim dhe menaxhim i platformave online për shit-blerje, marketing dhe promovim të automjeteve apo mjeteve detare/lundruese; konsulencë, ndërmjetësim dhe mbështetje në shit-blerjen e automjeteve; transport, logjistikë dhe menaxhim i importit dhe

eksportit të automjeteve; si dhe çdo aktivitet tjetër ligjor, direkt ose tërthor, që lidhet me automjete apo mjete detare/lundruese, tregtinë, qiranë, leasingun dhe menaxhimin e tyre."

Neni 5

Kohezgjatja

5.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 LEKE (njëqind mijë lekë), me vlerë nominale 100.000 LEKE (njëqind mijë lekë). Kuotat e kapitalit themeltar zoterojnë 100% të kapitalit me 1 (një) kote nga Ortaku Z. Florian Dedja me 1 Kote me 100% = (100.000 LEKE).
- 6.2 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të perfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.
- 6.3 Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/te paluajtshme apo të drejta)
- 6.4 Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 7.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme duke kontribuar në para ose me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime si dhe nga fitimet e Shoqërisë.
- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në Nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale.
- 7.3 Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e Shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

8.1 Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- Shit-Blerjes;
- Trashegimise;
- Dhurimit;
- Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

8.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me nënshkrimin e paleve përpara Notarit Publik

8.3 Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në

çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

8.4 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

9.2 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

9.3 Asambleja e Përgjithshme, vendos për çështje si:

- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të regjistruar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblese;

9.4 Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e përgjithshme regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare jetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- thirrjen e mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme.

9.5 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

9.6 Shoqëria nuk mund t'i kundërejtojë pavlefshmerinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirebesim, përveç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

10.1 Administrator i Shoqërisë është Z. Florian Dedja emëruar në këto detyra për një afat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë ripërteritje, me ID J80428053V

10.2 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme.

Neni 11

Kompetencat

Administratori detyrohet të:

- kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqërise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- perfaqesojë shoqërine tregtare;
- kujdeset per mbajjen e sakte e te regullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqërise;
- pergatiti dhe nënshkruaje bilancin jetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqërise;
- kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqërise, siç parashikohet ne ligjin per Qendrën Kombetare te Regjistrimit;
- raportoje perpara asambles se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqërise tregtare;

Administratori është i detyruar te therrase mbledhjen e asamblese se pergjithshme edhe ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e shoqërise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te Shoqërise, që rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Administratori ka te drejte:

- Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem.
- Administratori perfaqëson Shoqërine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, përfshi këtu autoritetet giyqësore te te gjitha shkalleve.
- Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar në marrëdhënie me te trete në emer te Shoqërise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te Shoqërise.
- Administratori angazhon shoqërine ne marrëdhëniet me te trete nëpermjet akteve që jane ne perputhje me objektin e saj.

SHENIM: Shoqëria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e Shoqërise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk është prove e mjaftueshme.

Neni 12 Pergjegjesite

12.1 Administratori është pergjegjes individualisht, ndaj Shoqërise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gate administrimit te Shoqërise. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme qe i sjellin dem Shoqërise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen,

per te perballuar ne mënyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

12.2 Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

12.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlersimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

12.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet Profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë Shoqërisë dëm, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë do fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

12.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i demshperblejë Shoqërisë dëm e shaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- u kthen ortakëve kontributet;
- u paguan ortakëve interesat apo dividende;
- u shperndan aktivet shoqërisë;
- lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare duhet të parashikohet që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

13.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i Shoqërisë dhe dividendet.

14.1 Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

14.2 Mbledhja e Ortakëve të Shoqërisë vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 *Ekspertet*

- 15.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të Shoqërisë, atë githyjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai shtet ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, i ngarkuar nga ana e asamblese së përgjithshme.
- 15.2 Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë asamblese së përgjithshme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

- 16.1 Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tregteve, i mbeten dhe i kalon në pronësi, Asamblese së Shoqërisë, të cilat mund të kalojnë dhe për zmadhimin e kapitalit.

Neni 17

- 17.1 Shpërndarja ose prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- me vendim të ortakut të vetëm;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit";
- me vendim të gjykatës;

- 17.2 Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

- 17.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen afësisht paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

- 17.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

- 17.5 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

- 18.1 Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emerimit të tij.

- 18.2 Nëse shoqëria emerohet me shume se një likuidues, përveçse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

- 18.3 Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundërshtohen të tregteve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

- 18.4 Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakëve dhe administratorit.

Neni 19
Te drejtat e detyrimit e likujduesit

- 19.1 Detyra e likujduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te Shoqërise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te Shoqërise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 19.2 Likujduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
- 19.3 Nëse, në baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ", likujduesit verejne se pasuria e Shoqërise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk shte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likujdimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.
- 19.4 Likujduesi pergatit nje bilanc te gendjes së Shoqërise ne çastin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne çastin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, githashtu, pasqyrat financiare vjetore te Shoqërise.
- 19.5 Bilancet ne Shoqërine kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjere, ndersa ne Shoqërite aksionare apo nga ato me pergjegjesi te kufizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme.

Neni 20
Perfundimi i likujdimit

- 20.1 Pas sherndarjes së aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çregjistrimin e Shoqërise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"


Neni 21
Bashkimi

Dy ose më shume Shoqëri mund te bashkohen nëpermjet:

- Kalimit te te gjitha aktiveve te pasiveve te njerës ose me shume prej Shoqërive, qe quhen Shoqërite e perthithura, te nje shoqëri tjeter ekzistuese, e quajtur shoqëria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kësaj Shoqërie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
- Themelimit te nje Shoqërie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e Shoqërive ekzistuese, qe bashkohen ne këmbim te aksioneve apo kuotave te Shoqërise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqërie te re.

Neni 22
Ndarja

- Nje Shoqëri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume Shoqërive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlersohet e prishur.
- Per ndarjen e Shoqërise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008.
- Shoqërite, qe fitojne pasurite e Shoqërise qe ndahet, quhen Shoqëri pritse dhe pergjigjen ne mënyre solidare per detyrimet e kësaj te fundit.



- Regjistrimi i ndarjes se Shoqërise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje kalimin te shoqërite pritesë te te gjitha aktiveve e pasiveve te Shoqërise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marrveshjen e ndarjes.
- Ky kalim sjell pasoja per marrëdhëniet ndermjet shoqërive, si dhe per palet e treta; berjen e aksionareve/ortakeve te Shoqërise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose më shume
- Shoqëriye pritesë, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar në marrveshjen e ndarjes.
- vleresimin e Shoqërise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23
Shnderrimi

- 23.1 Shoqëria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nëpermjet shnderrimit te saj ne Shoqëri aksionare.
- 23.2 Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqëria ka marre persiper ndaj te Treteve.

Neni 24
Baza Ligjore

- 24.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij në perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 24.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe Shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25
Mosmarreveshjet

- 25.1 Për mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 kopje me vlere te njejta juridike ne giuhen shqipe, dhe pasi iu lexua ortakeve themeltar te Shoqërise, nenshkruhet me vullnetin e tyre te lire nga ortaket themelues.

ORTAKU THEMELUES

Florian Dedja

